



VENDIM

Nr. 98, Datë 17.06.2016

MBI

**MIRATIMIN E LIÇENSËS PËR VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2 gërma ‘ç’ të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike, nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.06.2016, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës dhe relacionin përkatës, për miratimin e Licensës Për Veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike,

Vendosi:

1. Të miratojë “Liçensën për Veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike”. (bashkëlidhur)
2. Efektet e kësaj license për subjektet e licensuara nga ERE ne aktivitetin e furnizuesit te kualifikuar dhe furnizuesit publik me pakice, shtrihen për periudhën e mbetur të kohës së parashikuar në licensën aktuale.
3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI